



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 8

Prishtinë, më 10.3.2015, ora 13,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Fikrim Damka, Emilija Redzeqi, Lahi Brahimaj, Haxhi Shala, Adem Salihaj, Shaip Muja, Salih Salihu.

Mungoi : Velimir Rakiq, Murat Hoxha.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë : sipas listës së nënshkruar nga pjesëmarrësit.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi, Dalina Kërqeli.

Mbledhjen e kryesoi **Fikrim Damka**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës ,
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 25.2.2015,
3. Shqyrtimi dhe analiza e takimit të Komisionit me zyrtarët e Agjencionit të ushqimit dhe të Doganave,
4. Shqyrtimi i shkresës së dërguar nga Komisioni për legjislacion, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/39
5. Të ndryshme

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 25.2.2015

Kryetari i Komisionit konstatoi miratimin e komisionit për procesverbalin nga mbledhja e kaluar.

3. Shqyrtimi dhe analiza e takimeve të komisionit me AUV dhe Doganat

Kryetari përshëndeti të pranishmit dhe njoftoi shkurtimisht për takimet e fundit të grupit punues për çështjen e miellit, i cili grup pasi të ndërmerret edhe disa hapa të duhura, së shpejti do të sugjeroi lidhur me rekomandimet nga komisioni lidhur me këtë çështje, njëherit ai njoftoi se ka marr pjesë në vizitën e djeshme në AUV ku është premtuar që deri javën e ardhshme do të dërgohen kopjet e secilit dërgesë nga Serbia rreth fito certifikatës, megjithatë propozoi të dëgjohen pjesëmarrësit direkt në takimet e fundit nga grupi punues.

Salih Salihu theksoi se pas takimeve me AUV dhe Doganat dhe informatave që janë marr nga zyrtarët përkatës mund të konstatohen mjaft kontradikta, ngase njëra thotë nuk kemi pranuar ushqim (grurë) për kafshë, kurse tjetra thotë se është pranuar, madje 10.000 ton dhe atë vetëm nga një operatorë M/SILLOSI, gjithashtu GP nuk ka informata ku është shitur, ku ka shkuar etj dhe se për këtë mall nuk është paguar TVSH ngase ende duhet të përpunohet në Kosovë, me ç'rast grupi ka kërkuar komplet dokumentacionin fitosanitarë dhe të shkohet në IBK në vizitë për ta zbardhur problemin, përndryshe këtu mund të kemi ikje nga TVSH. Nga dy kontrata të siguruara deri tani nga Serbia, vazhdoi, shihet se kemi një çmim të ngjashëm si për mallin për kafshë ashtu edhe për njerëz, çka është mjaft e çuditshme, megjithatë ai premtoi se grupi punues do t'ia dal deri në fund të siguroi të dhënat e duhura.

Adem Salihaj gjithashtu u pajtua që ka mjaft kontradikta pas takimeve të deritashme, ngase fillimisht në Dogana konstatuan për 1000 ton, pastaj 3000 dhe në fund thanë “po po fjala është për 10.000 ton” dhe atë vetëm nga MS, poashtu konstatoi se këto të dhëna nuk përputhen me ato të AUV ngase ata thonë “asnjë kg nuk është lëshuar për kafshë”. Sugjeroi që të vazhdoi hulumtimi nga komisioni duke kërkuar edhe involvimin e Qeverisë, pastaj të mirën hapat e duhur, përndryshe raporti i dërguar nga AUV është tepër i mangët dhe kontradiktor dhe diçka këtu nuk është në rregull (në takimin me komisionin thanë “jo ska pasur”, ndërkaq tani thonë “te shohim”), përfundoi.

Kryetari u përpoq në balancimin e hapave që duhet të ndermirren duke pritur fillimisht të dërgohet dokumentacioni nga AUV, të vizitohet IBK, pastaj të ulët komisioni për diskutim.

Shaip Muja potencoi se përkundër manipulimeve me taksa etj, fokusi i tij i deritanishëm ka qenë të tregohet çfarë kualiteti i miellit po hyn në Kosovë, i cili miell ka qenë skandaloz edhe në Shqipëri dhe asnjëherë nuk është zbardhur çka është bërë me atë miell në Kosovë, ku gjendet. Për shkak se te ne nuk ka institucion të akredituar, ne kërkuam analizat të dihen a janë bërë jashtë, ndërsa përgjigja erdhi që janë dërguar më 25.2.2015, por çka me tërë periudhën e pasluftës, çfarë mielli ka përdor popullata, përfundoi dyshimin. Kualiteti i miellit te ne është shqetësues, ngase nga vet shkencëtarët e shtetit eksportues janë identifikuar dhe vërtetuar dyshimet, madje ka pasur edhe rezistencë të analizave të barnave me çka është dëmtuar edhe shëndeti i popullatës. Ai përfundoi se duhet të miremi me kualitetin e miellit, jo vetëm nga Devolli por nga të gjithë operatorët, ngase nëse mielli është i mirë, nuk do të ketë vështirësi tjera, “neve na lejohet të kërkojmë cilësinë e duhur” dhe nëse AUV nuk mundet duhet të kërkojmë një takim me AUV dhe ministrin përkatës të Qeverisë, përfundoi.

Lahi Brahimaj sikurse diskutuesit tjerë pyeti a bëhen nga dikush analizat dhe a ka ndonjë hetim në këtë drejtim për miellin e Serbisë, ngase ne nuk kemi problem vetëm me këtë produkt, spekulime bëhen gjithashtu edhe me mishin e pulës, venën nga Mali i zi dhe shumë produkte tjera ushqimore, pse nuk mirën me u analizua një nga një dhe pavarësisht duke aluduar në fajësinë e zyrtarëve vendor. Nuk ka lidhje, vazhdoi, pse hyn gruri për kafshë, por pse ajo shitet për njerëz, kush janë shitësit e farës dhe a janë të licencuar, pse nuk ka përgjigje në pyetje të parashtruara.

Emilija Redzepe lavdëroi punën e grupit punues i cili po punon me seriozitet mjaft të madhë në këtë drejtim duke analizuar faktet e dyshimta siç janë p.sh. çmimet e njëjta për dy produkte të ndryshme dhe falenderoi grupin punues.

Adem Salihaj tha se grupi punues do të vazhdoi me përkushtimin e deritanishëm sidomos rreth pyetjes se ku kan shkuar 10.000 ton të kthyer nga Shqipëria, gjithashtu ceku çështjen e aflatoxinës në misër më 2013 nga Bullgaria, që do të jetë objekt diskutimi nesër në IBK, ngase

gjithë ai helm ka shkuar tek secili nga ne ose duhet të vërtetohet ku shkoi, a u shitë apo u shkatërru dhe që është zbuluar nga Shqipëria.

Haxhi Shala parashtoi pyetjen pse nuk fillon komisioni të bashkëpunoi me prokurorinë publike, ngase ka mjaft argumente për këtë bashkëpunim.

Salih Salihu pohoi se është hera e parë që një komision parlamentar mirët me një hetim të tillë për cilësinë e miellit, por që duhet të vazhdohet ngase në një Serbi si e njohim ne, nuk mundet aq lehtë ti besohet për gjithë këto mallra të importuara, dhe është naive ti besohet një shteti të tillë, ne nuk mundemi gjithçka të prodhojmë por pse ky vend nuk provon me importu prej ndonjë shteti tjetër, përfundimisht kjo punë duhet të zbardhet, insistoi ai dhe pyeti : pse pas luftës është shfaqur shumë ma shumë sëmundja e kancerit në Kosovë, dikush duhet ta jap këtë përgjegje. Ai kishte edhe pyetje tjera siç është p.sh. pse AUV nuk bënë analiza vetë por i dërgon në IBK, të cilat ai shpresoi se do të zbardhen me përkushtimin e këtij komisioni.

Kryetari u përgjigj për pjesën e pyetjes rreth M/SILLOSI ngase komisioni në takimin me AUV ka kërkuar për të gjitha kompanitë analizat dhe ato jashtë vendit që janë bërë, gjithashtu shtoi se tani e tutje është kërkuar nga komisioni edhe involvimi i Fakultetit të Bujqësisë në hulumtime si institucion që do të kontribuoi në këtë drejtim.

Shaip Muja ndërhyri dhe insistoi prapë në cilësinë e grurit sidomos kur dihet se nga Serbia hyn gruri që nuk është kualitet, përndryshe opinioni do të futet në një krizë psikike. Një Qeveri e cila përdorë shpesh fjalën DO TË.... është e dyshimtë që nuk do ta bëjë atë që e premtonte. Serbia shet në Kosovë dhe Shqipëri kurse miell të mirë blen në Ukrainë, ai shtoi edhe problematikën me plehëra artificiale.

Lahi Brahimaj potencoi se në këto raste kemi të bëjmë me linja të veçanta në Serbi si p.sh. për cigare, verëra (Vranaci), mishi derri etj për ikjen nga tatimi dhe qëllime tjera, me çka mund të vijmë në përfundim se subvencionit është ma i mirë sesa të mbjellët p.sh. gruri nga një fermer (sepse fara është falso), një punë pa efekt është rrezik, përfundoi ai.

Shaip Muja u pajtua rreth ekzistimit të “linjave” të tilla , mirëpo ceku se problemet janë në Kosovë ku nuk kontrollohet asgjë dhe mori ca shembuj duke potencuar se Serbia shet gjëra jokualitative kurse ne i blejmë ato, pra Serbia ka gjetë tregun, përndryshe neve na mbetet me ngrit flamurin e bardhë, përfundoi. Polemizoi **Salih Salihu** me Shaip Mujën rreth cilësisë ngase faktet nga ai janë kundërtëne, pra , malli duhet të ndalet në kufi.

Kryetari Fikrim Damka falënderoi për kontributin dhe ftoi komisionin të përgatitet për mbledhjen e radhës kur do të kompletohen faktet e kërkuara nga GP.

4.Shqyrtimi i shkresës së dërguar nga Komisioni për legjislacion, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/39

Kryetari hapi diskutimin rreth iniciativës së komisionit për Legjislacion rreth Ligjit për kompleksin Adem Jashari por ndërhyri **Adem Salihaj** i cili tha se ky komision nuk ndërmer asgjë në këtë rast, mirëpo **Kryetari** potencoi faktin se pikërisht ky komision është kompetente në këtë rast për këtë ligj, ngase është hartuese e Ligjit për Agjencinë e komplekseve memoriale, ndërkaq pas ndërhyrjes edhe nga ana e **Shaip Mujës** rreth involvimit të komunave, kryetari pas marrjes së fjalës nga ana e përfaqësuesit të Agjencisë në fjalë të z. **Adnan Elshani** sugjeroi formimin e GP, komisioni nxori :

P Ë R F U N D I M

1. Themelohet grupi punues : Shaip Muja, Lahi Brahimaj, Murat Hoxha dhe Haxhi Shala, kryesuesi i së cilës do të caktohet nga vet GP.

2. Grupi punues do të shqyrtojë rrethanat se kush do ta hartojë ligjin e propozuar për kompleksin Adem Jashari nr. 2004/39.

3. Më 11.3.2015 në orën 10,00 komisioni përkatësisht grupi punues, viziton Institutin bujqësor të Kosovës në Pejë rreth çështjes së miellit.

4. Në mbledhjen e radhës Komisioni shqyrton draftin përfundimtar të Ligjit për ZRRUK e cila pastaj do të procedohet më tej.

5. Kërkesa e palës Leonora Krasniqi përçjellët në Ministrinë e Bujqësisë në shqyrtim të mëtejme.

Mbledhja përfundoi në orën 14,10.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,

Fikrim Damka